Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**02.11.2023**	**13.11.2023**	**2023/0843**
Eksperti Teknik **Donijeta Sogojeva**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **03.11.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.10.2023, OE "SRAHEP SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0843, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "SRAHEP SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me invertar per nevojat e KPSH-se" me nr. të prokurimit: "616-23-9889-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0843 i dt:27.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar

dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 51 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 17 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 24 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 25 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Pas kërkesës për rishqyrtim zyrtari i Prokurmit ka shkelur edhe dispozitat e parapara ne nenin 61 paragrafi 61.3

Autoriteti Kontraktues komuna e Prishtinës ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Furnizim me invertar për nevojat e KPSH-së, me nr. të prokurimit : 616-23-9889-1-1-1 dhe nr. të brendshëm: 616 23 180 111. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat favorizojnë ndonjë Operator Ekonomik pasi që nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokuirmit në fjalë. Me datën 18.10.2023 kemi paraqitur kërkesën për sqarimin e tenerit në lidhje me specifkimet teknike të paraqitura në dosjen e tenderit për për procedurën në fjalë në të cilën kemi kërkuar sqarim se në çfarë përqindje lejohet dallimi në dimensione tek inventari Medicinal, përkatësisht pozitat 25, 26, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, dhe 111. Pasi që duke e ditur që inventari medicinal nuk prodhohet në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk mund të bëhet "costum made" atëherë duhet të lejohet që dimensionet dhe specifikat të ndryshojnë së kaku /-10 % në mënyrë që të mundësohet sa më shumë pjesëmarrja e O.E. dhe prezantimi i brendeve të ndryshme . Përndryshe kjo qartazi paraqet shkelje dhe është në kundërshtim të plotë me Nenin 28 të LPP-s për specifikime teknike. Autoriteti Kontraktues në lidhje me kërkesën për sqarimin e tenderit të cekur më lartë nuk

na ofron sqarimin edhe përkundër që kërkesën e kemi paraqitur brenda afatit të përcaktuar kohor për sqarimin e dosjes së tenderit dhe Autoriteti Kontraktues është i obliguar që sa më parë të ofroj sqarimet dhe ti njoftoj operatorët ekonomik. Kështu që mos ofrimi i informatave sqaruese për Operatorët Ekonomik, kur kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor paraqet shkelje të dispozitave të nenit 24 të Rregullorës së Prokurimit 001/2022. Autoriteti Kontraktues ka hequr nga platforma elektronike dosjen e tenderit dhe në vend të sajë ka vendosur përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet sakt se cilat kushte duehet të plotësohen për të marrë pjesë në tender pasi që ka bërë korigjim të dosjes së tenderit por ndryshimet nuk i ka paraqitur në dosjen e re të tenderit. Mos vendosja e dosjes së tenderit në platformën elektronike paraqet shkelje të nenit 17 të Rregullorës së Prokurimit 001/2022 konkretisht paragrafët 17.12 dhe 17.16 Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kapaciteti teknik dhe profesional në pikën nr 6 ka paraqitur kërkesën: 6. Autorizimi i prodhuesit apo dilerit dhe Katallogu Broshura origjinale e prodhuesit per Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111

Kerkesa qe per pozicione e lartcekura te paraqitet autorizimi i prodhuesit apo dilerit të autorizuar e kufizon skajshmërisht konkurencën pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Gjithashtu nga AK janë paraqitur specifikat teknike të përshtatura pikëpërpikë për një prodhues. Kjo është në kundërshtim me Neni 28 të LPP-s – Specifikimet teknike – pasiqë për arsye të pershtatjes pikë për pikë te specifikimeve teknike te produkteve te prodhuesit "Turmed" per pozicionet.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 nuk është lënë mundësia që të konkurohet me produkte nga prodhuese tjerë. Andaj me kete specifikim teknik eshte ngushtuar pjesemarrja e Operatoreve Ekonomik te tjere gjegjesisht edhe prodhuesve te tjere me renome boterore.

https://www.turmedonline.com/UploadFile/Katalog/turmed-catalog_GsMpR.pdf ----- -----

linku i katalogut Turmed Nga katalogu i lartcekur vërehet qartë që specifikat teknike i janë përshtatur plotësisht prodhuesit Turmed. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-s pasi që diskriminohen prodhuesit tjerë si dhe ofertuesit të cilët planifikojnë që të marrin pjesë në këtë tender. Prandaj, kërkesa që O.E. të paraqesin Autorizimin e prodhuesit dhe Katallogu Broshura origjinale e prodhuesit per Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 duhet të hiqet pasi që sikur kemi cekur kjo kërkesë e favorizon vetëm prodhuesin Turmed dhe diskriminon prodhuesit apo O.E. tjerë.

Autorizimi është kërkesë e cila është në kundërshtim edhe me nenin 69 të LPP-s pasi që në asnjërin nga dispozitat e këtij neni nuk është dhënë mundësia për të kërkuar autorizimin e prodhuesit për produkte të caktuara. Pra sikur kemi cekur më lartë këto kërkesa janë në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues tek kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionoale neni 9.1 & 9.2 ne pikën nr. 3 ka paraparë kërkesën që O.E të jet i certifikuar me certifikaten ISO 13485 2016 e cila nuk është relevant me natyrën e projektit por kjo kerkes shihet qartas që është kërkuar me qëllim të favorizimit të ndonje O.E. andaj AK ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s.

Pasi kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues ka pezulluar procedurën e prokurimit por nuk na ka kthyer kurrëfarë përgjigje në lidhje me kërkesën tonë. Në nenin 61. paragrafi 6.3 të Rregullores 001/2022 për Porkurmin Publik është paraparë që Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Ne nuk kemi marrë kurrëfarë njoftimi për zgjatje të afatit edhe përkundër se ka kalua afati tre (3) ditor. Andaj,

Duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 63.2 të Rregullores 001/2022 për Porkurmin publikKërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurmit (OSHP) që në përputhje me kompetencat e juaja të parapara në dispozitat e LPP-së si dhe në dispozitat e lartcekura të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht të pezullon aktivitetin e prokurimit në fjalë deri sa të shqyrtohet ankesa jonë dhe të merret vendimi nga OSHP si dhë me rastin e vendiit të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të mënjanon kriteret diskriminuese teknike dhe ato të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë

dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës "L" për punë me dimensione të përgjithshme 150x70cm dhe h=75cm dhe pjesës anësore 130x50cm dhe h=73.2cm. Materiali i përdorur është pllakë zdrukthi melaminë e fisnikruar me trashësi 36mm, ngjyrë X. (Ngjyra dhe tekstura të konsultohen paraprakisht me organin mbikqyrës). Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantohen me shirit të të njejtës teksturë (ABS). Konstrukcioni me profile metalike me kualitet të lartëdhe e ngjyrosur me pluhur elektrostatik, në pjesën e poshtëm të këmbë të ketë mundësin e nivelizimit të tavolinës, me prerje tërthore 80x40mm.

Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës per pune me dimensione të përgjithshme 150x70cm dhe h=75cm. Materiali i përdorur është pllakë zdrukthi melaminë e fisnikruar me trashësi 36mm, ngjyrë X. (Ngjyra dhe tekstura të konsultohen paraprakisht me organin mbikqyrës). Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantohen me shirit të të njejtës teksturë (ABS). Konstrukcioni me profile metalike me kualitet të lartëdhe e ngjyrosur me pluhur elektrostatik, në pjesën e poshtëm të këmbë të ketë mundësin e nivelizimit të tavolinës, me prerje tërthore 80x40mm.

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për pune në laborator me dimensione 70x65cm h=75cm.

Materiali: Pjesa e sipërme - Panel i presuar (ivericë) me trashësi 40mm nga druri i kompaktësuar në temperaturë dhe presion të lartë të përshtatshme për përdorim në laboratore dhe intervenca, me sipërfaqe antibakteriale që siguruon mbrojtje superiore kundër një game të gjerë të kemikaleve, rezistencë ndaj preparateve kimike, rezistencë ndaj njollave, gërvishtjes dhe shtypjes, ideale për mejdiset e kujdesit shëndetsor. Këmbët duhet të jenë statike me profile 40x40/2mm dhe 30x50/4mm, tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë. "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për destilator me dimensione 65x70cm dhe h=75. Materiali: Pjesa e sipërme pllakë zdrukthi melaminë, densideti (600- 700kg/m3), t=40mm pllaka duhet të jete antibakteriale,(paraprakishte konsultohet me organin mbikqyrës). Eshtë përdorur prerje tërthore e profileve t= 40x40mm/2mm prej metalit te galvanizuar, antikorodues me ngjyrë të bardhë. Mënyra e

ngjitjes (fiksimit) të panelit me këmbëzat e metalta, propozohet nga prodhuesi varësisht prej teknologjisë së përdorur, gjithmonë në konsultë me organin mbikqyrës. Këmbët duhet të jenë statike dhe tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome.

1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë."

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për zyre me dimensione 180x90cm, dhe h=75. Tavolina është e përbërë nga dy pjesë materiali i përdorur është pllakë zdrukthi melaminë e fisnikëruar me trashesi 36 mm. Eshtë përdorur prerje tërthore e profileve t= 40x40mm/2mm prej metalit te galvanizuar, antikorodues me ngjyrë të bardhë. (Ngjyra dhe tekstura te konsulltohen paraprakisht me organin mbikqyrës. Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantohen me shirit të së njëjtes teksturë (ABS).

Pjesa ndihmëse e tavolines me dimensione 165x50cm dhe h=71cm. Materiali i përdorur është pllakë zdrukthi melaminë. Eshtë përdorur prerje tërthore e profileve t= 40x40mm/2mm prej metalit te galvanizuar, antikorodues me ngjyrë të bardhë.. (Ngjyra dhe tekstura te konsulltohen paraprakisht me organin mbikqyrës. Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantohen me shirit të së njëjtes teksturë (ABS). ."

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për 6 persona, e jashtme -Madhësia e përgjithshme: Gjerësia: 90 cm, Gjatësia: 150 cm, Lartësia: 74cm.

Bordi Materiali: Kornizë: Alumini, Pllaka: dru artificiale

Alumini duhet te jete material i lehtë dhe elegant që nuk ndryshket. Dhe nuk kërkon ndonjë mirëmbajtje dhe dueht te pastrohet lehtësisht me një leckë të lagur.

Dru duhet te jete artificiale e plastikës i quajtur polistiren. Me pamjen dhe strukturën e saj natyrale duket si dru, por nuk kërkon të njëjtën mirëmbajtje te i mbrojtur me UV. Ajo mund të përballojë çdo mot dhe lehtë të pastër me sapun dhe ujë.

Forma: drejtkëndore. "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për kuzhinë me dimensione: 245x75cm dhe h=75.

Materiali: MDF: Ngjyra: E bardhë; Këmbët: krom
Kapacitetit për 8 persona "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për kuzhinë me dimensione: 215x75cm dhe h=75.

Materiali: MDF: Ngjyra: E bardhë; Këmbët: krom
Kapacitetit për 8 persona "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për kuzhinë me dimensione: 160x80cm dhe h=75.

Materiali: MDF: Ngjyra: E bardhë; Këmbët: krom
Kapacitetit për 8 persona "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për vendosjen e matësit të gjatësisë dhe peshores, me dimensione të përgjithshme 120x60cm dhe h=75; Materiali është pllakë zdrukthi melaminë me trashësi t=36mm. Konstrukcioni i tavolinës është me profile metalike me prerje tërthore 40x50mm/2mm.

Pozicioni përfshinë të gjitha materialet e tjera të imëta dhe punët e nevojshme të specifikuara me vizatim që ky aktivitet të jetë i përfunduar dhe funksional. Para së gjithash, duhet të prezantohet një prototip dhe të merr miratimin e organit mbikëqyrës për të vazhduar me punimin e të tjerave. Prodhuesi

duhet ti respektoj të gjitha normat teknike Europiane dhe të garantoj për produktin e tij së paku 5 vite."

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për sterilizator me dimensione të përgjithëshme 120x60cm dhe h=75cm. Materiali i përdorur është Phenolix me trashësi 10mm, me ngjyrë x, i përshtatshëm për përdorim në laboratore dhe intervenca, me sipërfaqe antibakteriale që siguron mbrojtje superiore ndaj një game të gjerë të kemikaleve, rezistencë ndaj preparateve kimike, rezistencë ndaj njollave, gërvishtjes dhe shtypjes, ideale për mjediset e kujdesit shëndetsor. Paneli në të gjitha anët perimetrale të tavolinës dublifikohet për të arritur trashësinë prej 36mm. (Ngjyra të konsultohet paraprakisht me organin mbikqyrës). Të gjitha anët e panelit të prerë duhet të kantohen me shirit të të njejtës teksturë (ABS). Këmbët janë të punuara nga profile metalike (metali i galvanizuar, anti korrodues) ngjyrë X. Janë përdorur dy prerje të ndryshme tërthore të profileve, rrespektivisht 50x40mm si dhe 30x30mm.

Mënyra e ngjitjes (fiksimit) së panelit me këmbëzat e metalta, propozohet nga prodhuesi varësisht prej teknologjisë së përdorur, gjithmonë në konsultë me organin mbikqyrës. Këmbëzat duhet të jenë statike dhe tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë.

"

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për mikrokirurgji me dimensione 80x80cm dhe h=75. Materiali: Pjesa e sipërme - Phenolix me trashësi 10mm e përshtatshme për perdorim në laboratore dhe intervenca, me siperfaqe antibakteriale që siguruon mbrojtje superiore kundër një game të gjerë të kemikaleve, rezistencë ndaj preparateve kimike, rezistencë ndaj njollave, gërvishtjes dhe shtypjes, ideale për mjediset e kujdesit shëndetsor.

Këmbë duhet të jenë statike dhe tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë.

"

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës për inhalim me dimensione 80x80cm dhe h=75cm. Materiali i përdorur është pllakë zdrukthi melaminë, densiteti (600 - 700kg/m3) me trashësi t=36mm, me ngjyrë X, (ngjyra të konsultohet paraprakisht me organin mbikqyrës). Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantohen me shirit të të njejtës teksturë (ABS). Këmbët janë të punuara nga profile metalike (metali i galvanizuar, anti korrodues) ngjyrë X. Janë përdorur dy prerje të ndryshme tërthore të profileve, rrespektivisht 50x40mm/2mm si dhe 30x30mm/2mm. Mënyra e ngjitjes (fiksimit) të panelit të pllakës me këmbëzat e metalta, propozohet nga prodhuesi varësisht prej teknologjisë së përdorur, gjithmonë në konsultë me organin mbikqyrës. Këmbëzat duhet të jenë statike dhe tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë.

"

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës per punë për laboratorë e përbërë prej tri pjesëve me këto dimensione:

260x90cm dhe h=75cm

297x90cm dhe h=75cm

385x90cm dhe h=75cm

Materiali: Pjesa e sipërme -Panel i presuare (iverice)me trashësi 40mm nga druri i kompaktësuar në temperaturë dhe presion të lartë të përshtatshme për përdorim në laboratore dhe intervenca, me siperfaqe antibakteriale që siguruon mbrojtje superiore kundër një game të gjerë të kemikaleve,

rezistencë ndaj preparateve kimike, rezistencë ndaj njollave, gërvishtjes dhe shtypjes, ideale për mejdiset e kujdesit shëndetsor. Këmbët duhet të jenë statike me profile 40x40/2mm dhe 30x50/4mm, tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë. "

"Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës per punë për laboratorë e përbërë prej tri pjesëve me këto dimensione:

270x90cm dhe h=75cm

370x90cm dhe h=75cm

390x90cm dhe h=75cm

Materiali: Pjesa e sipërme -Panel i presuare (iverice)me trashësi 40mm nga druri i kompaktësuar në temperaturë dhe presion të lartë të përshtatshme për përdorim në laboratore dhe intervenca, me siperfaqe antibakteriale që siguruon mbrojtje superiore kundër një game të gjerë të kemikaleve, rezistencë ndaj preparateve kimike, rezistencë ndaj njollave, gërvishtjes dhe shtypjes, ideale për mejdiset e kujdesit shëndetsor. Këmbët duhet të jenë statike me profile 40x40/2mm dhe 30x50/4mm, tabani i mbështetjes realizohet me material prej gome > 1 cm, me qëllim të mos dëmtimit të dyshemesë. "

Furnizimi, blerja dhe montimi i tavolinës lëvizëse me dimensione 57x77cm h=100h. Përbëhet prej dy ose tri niveleve, pjesës për përgatitje dhe rafti në mes. Materiali I përdorur është nga metali me ngjyrë X, metali duhet të jetë antikorodues.(ngjyra dhe tekstura të konsulltohen paraprakisht me organin mbikqyrës). Duhet të jetë me rrota me rrotullim 360°.

Tavolina per kafe .Tavolina te vogël me dimensione me diameter 60 dhe diameter 50 .

"Furnizimi, blerja dhe montimi i kariges per kopshte me dimensione. Madhësia e përgjithshme: Gjerësia: 54 cm, Gjatësia: 91 cm, Gjatësia: 71 cm

Karrige Materiali: Kornizë: Çelik, Mbrapa: Textiline, Vende: Textiline, Ansoret: alimin/metal

Materiali: Çelik. Textiline

Ngjyra: E zezë ose tjeter "

"Furnizimi, blerja dhe montimi I ulëses terpeutike me mbështetëse nga materiali i çelikut

Mekanizmi : e rrotullues

Tapiceri me shkumë PU të mbuluar me PVC

Rregullimi i lartësisë pneumatike

Lartësia Përafërsisht Dim (mm): 450 - 560mm "

"Furnizimi. blerja dhe montimi i ulëses komode nga materiali poliester, Këmbët ahu i ngurtë

Trajtimi: lacquered

Ngjyra: Anthracite gray, Beech, e ose ndonje ngjyre tjeter

Madhësia e përgjithshme: Gjerësia: 58 cm, Gjatësia: 78 cm, Thellësia: 53 cm

Lartësia e vendndodhjes: 45

Thellësia e vendit: 43 "

"Furnizimi, blerja dhe montimi I karige për takime me dimensione:

Gjerësia: 60 cm, Gjatësia: 64 cm, Gjatësia: 57 cm

Pesha: 12 kg

Materiali: Metal, poliestër / shkumë.

"

"Furnizimi, blerja dhe montimi i karrigës për marrjen e gjakut me këto specifikacione:
Lartësi fikse, Lartësia - 52cm

Dimensionet e platformes -57-165cm, Dimensionet e jashtme 66x165cm, Pesha bartese 240kg

Konstruksioni i çelikut, e lyer me ngjyrë epoksi

"

Furnizimi, blerja dhe montimi I karrigave rrotulluese per pacient pa mbeshtese, nga materiali inox, ulesja material vinyl, lartesia menyre hidrualike, 5 rrota,lartesia e rregullueshme 57-77cm, diametri I rrotave 5-7cm

Furnizimi, blerja dhe montimi I karrigave rrotulluese per pacient pa mbeshtese nga materiali inox, ulesja material vinyl, lartesia menyre hidrualike, 5 rrota,lartesia e rregullueshme 57-77cm, diametri I rrotave 5-7cm

Furnizimi, blerja dhe montimi I karrikave 3-she metalike, D-60cm, W-150cm, H83cm, height of setas 43cm, max load 300kg

Furnizimi, blerja dhe montimi I karrikave 2-she metalike, D-60cm, W-100cm, H83cm, height of setas 43cm, max load 250kg

"Furnizimi, blerja dhe montimi i ulëses për doktor - marrja e gjakut
Materiale : nga i çelikut

Mekanizmi : e rrotullues

Tapiceri me shkumë PU të mbuluar me PVC

Rregullimi i lartësisë pneumatike

Lartësia Përafërsisht Dim (mm): 450 - 560mm. "

Furnizimi, blerja dhe montimi i tabures për garderobë me dimensione 60x40cm dhe h=45cm.

"Furnizimi, blerja dhe vendosja e karrikes për kuzhinë me këto specifika:
Dimensionet : Gjerësia: 50 cm, Lartësia: 85 cm, Thellësia: 53 cm

Pesha: 20 kg

Materiali: ulësja nga paneli i drurit të presuar, këmbët krom

Ngjyra: bardhë "

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Srahep" Sh.P.K. të datës 23.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me invertar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

VENDIM

I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Srahep" Sh.P.K. e datës 23.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me invertar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Srahep" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Srahep" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me invertar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 8

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **SRAHEP SH.P.K.**

Ekspertja teknike konstaton se ne FDT te Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, AK ka deklaruar se SPECIFIKIMET TEKNIKE MUND TE SHKARKOHEN PERMES E-PROKURIMIT, por vetem te Paramasa dhe Parallogaria kam gjetur pershkrimin e produkteve. Ne disa pozicione eshte cituar "Furnizimi, blerja dhe montimi ...", duke bere te paqart kerkesen per pozicionin me fjalet Furnizim dhe Blerje !? Autorizimi nga prodhuesi apo dileri eshte kriter qe vendoset nga AK per te deshmuar konformitetin e produktit nga vet Prodhuesi apo Dileri se jane plotesuar kerkesat teknike te percaktuara me dispozita qe zbatohen per nje produkt te caktuar.

Ekspertja teknike konstaton se ka OE ankues ka ofruar katallogun e prodhuesit TURMED duke pretenduar se pozicionet: 23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 jane me specifikacione teknik te pershtatur per kete prodhues, por OE ankues nuk ka deshmuar me fakte ose prove se ku gjinden keto pozicione ne katallog te ketij prodhuesi, dhe nuk ka bere vertetim te ketij pretendimi ankimore andaj vleresohet pjeserisht e bazuar.

Kriteri per Autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi, eshte i domosdoshem per produkte vitale te AK, sepse e siguron qe jane konforme kerkesave teknike.

Katallogu ose foto me pershkrim teknik nga prodhuesit, ofrojne shume-llojshmeri te tipeve per nje produkt dhe nuk duhet te konsiderohet kriter diskriminues.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përshkruan kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë në industrinë e pajisjeve mjekësore. Ky standard është specifik për pajisjet mjekësore dhe mbulon të gjithë ciklin e jetës së një pajisjeje, nga projektimi dhe zhvillimi deri te prodhimi, instalimi dhe servisimi. Ai synon të sigurojë që pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive për përdorimin e tyre të synuar, andaj eshte e drejte e AK ta vendose ne kriter.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjeserisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit duke lejuar nje tolerance +/-5% te dimensioneve dhe peshave te inventarit me perjashtim te pajisjeve qe

domosdoshmerisht per arsye objektive duhet te kene dimensionet dhe peshen ashtu si eshte kerkuar, dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **SRAHEP SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS PANEL I SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili

Donijeta Sogojeva

Sogojeva